

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARNOLD HAJRO  
ADRESA Blvd. "Gjergj Fishta", P.  
Teknoprojekt, Kulla 1, Kt. 1, Tiranë  
TEL: 0692045569


## DEKLARATË NOTERIALE

(PËR PRANIM DHURIMI)

Nr. repertori: 312

Nr. koleksioni: 188

Tirane më 16/06/2021



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 1 fletë



A2021053970010237794



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERISË TIRANË  
(U aplikua pulla e taksës)



## DEKLARATË NOTERIALE

- PËR PRANIM DHURIMI -

Sot, më datën **16.06.2021** (dymijë e njëzet e një) paradite, në Tiranë, para meje noterit Arnold HAJRO, me seli në adresën: Blvd. "Gj. Fishta", P. Teknoprojekt, Kulla 1, Kt. 1, Tiranë, u paraqit personalisht deklaruesi:

- **Z. Valdrin RUSHITI**, atësia Shaban, lindur në Malishevë, Gjilan (KS), me dtl. 28-04-1993, shtetas kosovar, me adresë: Rr. "Imzot Nikëprela", Prishtinë (KS), mbajtës i Kartës së Identitetit (RKS) me nr. ID1765293 dhe nr. personal 1231277095.

Pasi konstatova se i paraqituri, ka të gjitha aftësitë e parashikuara nga ligji, (person madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar), në bazë të Ligjit nr. 110/2018, dt. 20.12.2018 "Për Noterinë", unë noteri, pasi i bëra të qartë përgjegjësinë me të cilën e ngarkon ligji në rast deklarimi të vesuar, në përputhje me kërkesën dhe vullnetin e tij të lirë e të plotë, redaktova këtë deklaratë noteriale si më poshtë vijon;

"Unë i nënshkruari jam njohur me përmbajtjen e aktit noterial "AKT DHURIMI" Nr. Rep. 294, Kol. 175, datë 10.06.2021 – Noter Arnold Hajro, Tiranë, mbi dhurimin pa kundërshtim apo kushte të tjera të 100 % (njëqind përqind) të kuotës të shoqërisë "SCHOOL OF ADVANCED LEARNING ALBANIA" shpk, nga Dhuruesi Z. Gerd FAGU, në favorin tim.

Deklaroj me vullnet të lirë e përgjegjësi të plotë, se pranoj, pa asnjë rezervë, me mirënjohje dhe respekt, pasurinë e luajtshme – kuotën e vetme prej 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë tregtare, të përshkruar në aktin e dhurimit dhe jap miratimin tim për regjistrimin e të drejtave të pronësisë nga Qendra Kombëtare e Biznesit Tiranë, si dhe çdo autoritet tjetër të ngarkuar nga ligji."

\* \* \* \* \*

Unë, Noteri, mora autorizimin për përdorimin e të dhënave personale të palës/ palëve, duke garantuar se të dhënat e përdorura në këtë dokument do të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllim të redaktimit të këtij akti, në përputhje rigoroze me ligjin nr. 9887, dt. 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Pasi ua lexova palës, me zë të lartë e të qartë, tekstin e këtij akti, konstatova se përmbajtja e tij, u gjet në përputhje me vullnetin e lirë dhe të plotë, u nënshkrua rregullisht para meje, dhe unë, Noteri, vërtetoj nënshkrimin e tij, sipas legjislacionit të RSH.

### NËNSHKRIMET E PALËVE

#### DEKLARUES

Z. Valdrin RUSHITI

*Valdrin Rushiti*  
(emër, mbiemër/ firmë)

#### NOTER

Arnold HAJRO

*Arnold Hajro*



Studio Noteriale - Arnold Hajro

ADRESA : Blvd. "Gjergj Fishta", P. Teknoprojekt, Kulla 1, Kt. 1, Tiranë, SHQIPËRI  
Mob: +355 69 20 45 569; e-mail: hajro\_arnold@yahoo.com

Fq. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË


NOTER ARNOLD HAJRO  
ADRESA Blvd. "Gjergj Fishta", P.  
Teknoprojekt, Kulla 1, Kt. 1, Tiranë  
TEL: 0692045569

# AKT DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 294

Nr. koleksioni: 175

Tirane më 10/06/2021



Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2021053970008938162



A2021053970008938162

## AKT DHURIMI

- PASURI E LUAJTSHME KUOTA KAPITALI

Sot, më datën 10 QERSHOR, 2021 (dymijë e njëzet e një) paradite, në Tiranë, para meje noterit Arnold HAJRO, me seli në adresën: Blvd. "Gjergj Fishta", Pall. Teknoprojekt, Kulla 1, Kt. 1, Tiranë, u paraqitën personalisht palët:

**PALA DHURUESE:** Z. Gerd FAGU, atësia Astrit, lindur në Tiranë, me dtl. 26-09-1990, shtetas shqiptar, banues në adresën: Nj. Bashkiake Nr. 2, Rr. "Vllazën Huta", Tiranë, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. 027651346-J00926048F, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar (këtu e më poshtë do të referohet si "Dhuruesi");

Pasi verifikova statusin ligjor të palës së sipërpërmendur, të njohur personalisht prej meje, unë, noteri, konstatova se është në përputhje të plotë me ligjin. Pala Dhuruese, me vullnetin e tij të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Civile dhe legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare, ka kërkuar hartimin e këtij akti, sipas kushteve të mëposhtme:

### KUSHTE PARAPRAKE

1. Dhuruesi Ortak i vetem i Shoqërisë "SCHOOL OF ADVANCED LEARNING ALBANIA" shpk ka në pronësi 100 % (njëqind përqind) të kuotave të shoqërisë "SCHOOL OF ADVANCED LEARNING ALBANIA" shpk, me NUIS L92002019V, me seli në adresën: Rr. "Myslym Shyri", P.47 Zyra 3/1, Tiranë.
2. Dhuruesi ka tagër të plotë për të vepruar sipas Vendimit Nr. 09, dt. 31.05.2021, të Asamblesë së Përgjithshme/Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.
3. Sipas Ekstraktit të QKB mbi kuotat e kapitalit themeltar të shoqërisë, nuk rezulton ndonjë barrë siguroese.
4. Vlera e Kuotes që Ortaku po dhuron është 100.000.00 lekë sipas Ekstraktit të QKB.

### NENI 1 - OBJEKTI

Objekti i kësaj kontrate është dhurimi e 100 % (njëqind përqind) të kuotës të shoqërisë "SCHOOL OF ADVANCED LEARNING ALBANIA" shpk, nga Dhuruesi në favor të pranuesit të këtij dhurimi - Përfituesit – Z. Valdrin RUSHITI, atësia Shaban, lindur në Malishevë, Gjilan (KS), me dtl. 28-04-1993, shtetas kosovar, mbajtës i Kartës së Identitetit (RKS) me nr. ID1765293 dhe nr. personal 1231277095, kundrejt kushteve të këtij akti.

Pranimi i dhurimit do të bëhet nga Përfituesi me një akt pranimi, të veçantë, të mëvonshëm, në përputhje me parashikimet përkatëse të legjislacionit në fuqi.

Dhurimi do të quhet i përfunduar, nga momenti kur akti i pranimi i është njoftuar Dhuruesit.

### NENI 2 - DHURIMI

- 2.1. Shitësi ia dhuron këtë pasuri përfituesit në masën 100 % (njëqind përqind) të kuotës të shoqërisë "SCHOOL OF ADVANCED LEARNING ALBANIA" shpk me NUIS L92002019V.
- 2.2. Bashke me të drejtat dhe detyrimet, Dhuruesi i kalon Përfituesit të gjithë dokumentacionin e shoqërisë së lartpërmendur.
- 2.3. Te gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë së lartpërmendur, i kalojnë Përfituesit sipas Ligjit mbi të ardhurat personale, të cilat ai i merr persiper t'i deklarojë me DIVA-n e tij sipas afateve ligjore.



Studio Noteriale - Arnold Hajro

ADRESA : Blvd. "Gjergj Fishta", Pall. Teknoprojekt, Kulla 1, Kt. 1, Tiranë, SHQIPËRI  
Mob: +355 69 20 45 569; e-mail: hajro\_arnold@yahoo.com

Fq. 1



A2021053970008938162

### NENI 3 - TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

- 3.1. Dhuruesi garanton perfituesin për titullin e pronësisë të pasurisë objekt kontrate dhe për saktësinë e dokumentacionit zyrtar të saj, në të kundërt mban përgjegjësi civile për dëmin e shkaktuar.
- 3.2. Dhuruesi është i dorëzon Perfituesit me nënshkrimin e këtij akti dhe regjistrimin pranë QKB, të drejtat e pronësisë mbi kuotën e dhuruar me të gjithë dokumentacionin përkatës.

### NENI 4 - KALIMI I PRONËSISË

- 4.1 Me nënshkrimin e aktit, dhe pranimin e tij me një akt noterial nga Përfituesi, Dhuruesi, zhvishet plotësisht nga pronësia mbi 100 % (njëqind përqind) të kuotës objekt kontrate, dhe perfituesi bëhet ortak i vetëm i shoqërisë me zotim 100% të kuotës, të drejtave dhe detyrimeve.

### NENI 5 - TË NDRYSHME

- 5.1. Palët duhet që të depozitojnë këtë akt dhurimi së bashku me aktin e pranimin, në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- 5.2. Pala dhuruese merr përsipër të mos e pengojë në asnjë rast Përfituesin në përmbushjen e detyrimeve kontraktore, në të kundërt është përgjegjëse për demet dhe mos përmbushjen kontraktore, në zbatim të dispozitave të kësaj kontrate dhe të Kodit Civil. Të njëjtat garanci duhet të konfirmohen edhe nga Përfituesi në aktin e pranimin të dhurimit.
- 5.3. Per çështjet apo paqartësitë që mund të lindin për objektin e kësaj kontrate, interpretimi dhe zgjidhja e tyre do të kryhet mbështetur në Kodin Civil, Kreu III, neni 761 e vijues të tij. dhe në zakonet e mira në marrëdhëniet kontraktore të kësaj natyre.
- 5.4. Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin për shkak të ekzekutimit të kësaj kontrate. Në rast se mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 5.5. Pjesë e pandare e kësaj Kontratë janë edhe:
- Ekstrakt historik i Shoqërisë "SCHOOL OF ADVANCED LEARNING ALBANIA" shpk.
  - Vendim Nr. Prot. 09, dt. 31.05.2021, i Asamblesë së Ortakut të vetëm të Shoqërisë "SCHOOL OF ADVANCED LEARNING ALBANIA" shpk. për aprovimin e dhurimit 100 % të kuotës së Shoqërisë

\* \* \* \* \*

Unë, Noteri, mora autorizimin për përdorimin e të dhënave personale të palës/ palëve, duke garantuar se të dhënat e përdorura në këtë dokument, do të jenë konfidenciale dhe vetëm për qëllim të redaktimit të këtij akti, në përputhje rigoroz me ligjin nr. 9887, dt. 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Ky akt, i përpiluar në 4 kopje origjinale (një prej të cilave ruhet në arkivin e noterit), ju lexua palëve, të cilët pasi e gjetën përmbajtjen e tij, konform kërkit dhe vullnetit të tyre të plotë, në prezencën time e pranuan aktin dhe e nënshkruan atë, dhe unë Noteri vërtetoj nënshkrimet, në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

## NËNSHKRIMET E PALËVE

**PALA DHURUESE**

Z. Gerd FAGU

*Gerd Fagu*  
(emër, mësimi/firmë)

**NOTER**

Arnold HAJRO

*Arnold Hajro*

*Studio Noteriale - Arnold Hajro*

ADRESA : Blvd. "Gjergj Fishta", Pall. Teknoprojekt, Kulla 1, Kt. 1, Tiranë, SHQIPËRI  
Mob: +355 69 20 45 569; e-mail: hajro\_arnold@yahoo.com

Fq. 2